



E hënë, 9 mars 2015

## NJOFTIM PËR MEDIA

### **Publikimi i Raporteve Konsultative për të Hyrat e Lejuara Maksimale(MAR) që do të mblidhen nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar**

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), ka publikuar në webfaqen e saj [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org), raportet konsultative për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) që do të mblidhen nga Furnizuesi Publik nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.

Gjatë shqyrtimit për të Hyrat e Lejuara Maksimale, ZRRE ka analizuar në detaje të gjitha kostot e sistemit të energjisë elektrike. Propozimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulojnë kostot për furnizim të publikut me energji elektrike për vitin tarifor 2015 është në vlerë prej 256,730,101 euro, e cila është më e madhe për 1.72% në krahasim me të Hyrat Lejuara Maksimale të vitit 2014. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të vitit 2014, duke përfshirë edhe shqyrtimin e jashtëzakonshëm ishin 252,389,459 euro.

Kjo do të thotë se Furnizuesi Publik varësisht nga konsumi i parashikuar për kategori të ndryshme të konsumatorëve do të mbledh përmes tarifave shumë prej 256,730,101 euro, e cila i mbulon të gjitha kostot e gjenerimit, transmisionit, shpërndarjes dhe furnizimit të Energjisë Elektrike deri tek konsumatorët fundor.

Për shkak të kompleksitetit të procesit tarifor, duhet të theksohet se ky propozim për MAR nuk parqet Vendim për ndryshimin e tarifave me pakicë të konsumatorëve fundor. Vlerat e sakta të tarifave me pakicë do të jenë të njohura vetëm pas aprovimit nga Bordi i ZRRE-së, pasi të kryhet analiza e parashikimeve për konsum në secilën kategori të konsumatorëve dhe në kohën e atij konsumi.

Raportet Konsultative për të Hyrat e Lejuara Maksimale janë publikuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE: [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org). ZRRE fton të gjitha palët e interesit të japin komentet e tyre në këto dokument deri me datë 23.03.2015. Komentet mund të dërgohen në emalin [info@ero-ks.org](mailto:info@ero-ks.org) me titull "Komente për SHTE9", ose në adresën postare: Rr. Dervish Rozhaja, Nr.12, 10000 Prishtinë, Kosovë.